



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr 7303 Prot

Datë 09/05 2022

URDHËR Nr 376 Datë 09/05 2022

**“PËR LIRIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZBATIMIN E INVESTIMIT ME
OBJEKT “SISTEMIM, ASFALTIM I RRUGES OBLIKE-PALLATE”**

Në zbatim të nenit 8,9 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9780 dt 16.07.2007 neni 4 “Për inpektimin e ndërtimit”, ligjit 107/2014 neni 39 “Për planifikimin e Territorit” i ndryshuar, neni 11, pika ç) të VKM nr 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, për zbatimin e investimit sipas kontratës së sipërmarrjes me nr.24576/8 datë 16.02.2022 “Per kryerjen e punimeve në objektin: “Sistemim, asfaltim i rrugës Oblikë-Pallate” në Njësinë administrative Ana e Malit, në zbatim të Lejes së Ndërtimit - Deklaratë paraprake nr.96 datë 08.02.2022 lëshuar nga Bashkia Shkodër, sipas gjurmës së projektit të miratuar për prishjet e objekteve,

URDHËROJ :

1. Prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje dhe që kanë zënë hapësirën publike brenda datës 31.05.2022, sipas gjurmës së projektit të miratuar për zbatimin e investimit “Sistemim, asfaltim i rrugës Oblike-Pallate”, planimetri e bashkëngjitur këtij urdhëri.
2. Ngarkohet grupi i përbërë nga inspektorët e Inpektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) listuar më poshtë, që brenda datës 20 prill 2022 të kryejë njoftimin, duke plotësuar dhe dorëzuar secilit posedues të objektit të ndërtuar pa leje, njoftimin përkatës sipas Aneksit “Njoftim për prishje dhe lirim të hapsires publike” bashkëngjitur këtij urdhëri.
 - Gentian Ibro, Kryeinspektor IMT
 - Mirsad Halluni, inspektor IMT
 - Ergys Karametaj, ndihmës inspektor IMT

Grupi i IMT i raporton me shkrim Kryetarit të Bashkisë për punën e kryer brenda datës 31.05.2022.

3. Ngarkohen për organizimin dhe koordinimin kontrollin dhe monitorimin e punimeve të prishjes grupi i punës i përbërë nga:

- Ardir Çylybyli, Zv. Kryetar i Bashkisë Shkoder, Kryetar
- Arben Ceni, Administrator i Njesisë Administrative _____, anëtar
- Gent Nehani, Kryeinspektor i Policisë Bashkiake, anëtar
- Afrim Elbasani, polic i Policisë Bashkiake, anëtar
- Fran Voci, polic i Policisë Bashkiake, anëtar
- Fatmir Perseku, polic i Policisë Bashkiake, anëtar

4. Ngarkohet për kryerjen e punimeve të prishjes grupi i punës së Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizime Shkodër:

Emër Mbiemër	Mjeti/mjetet e punës/makineri
Pjerin Ortori	Fadromë targa AA 916 YX
Briland Kuluri	Elektracist

5. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse për furnizimin e makinerive të punës me karburant nga planizimi për funksionet e shërbimeve publike.

6. Ngarkohet Zv. Kryetari i Bashkisë Shkodër Ardir Çylybyli të raportojë me shkrim Kryetarit të Bashkisë për çdo problem gjatë zbatimit dhe pas realizimit të detyrave të caktuara sipas këtij urdhëri nga secili, brenda datës 31 Maj 2022.

KRYETARI

BARDH SPAHIA

